



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS · REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË · OPŠTINA VITINA

Pranuar - Primiçena Më/Dana 29-03-2024			
Nr. i organit Org. broj	Numeri/Broj	Sheqicë Prilog	Vlera Wertigkeit
01	110	105	305



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, neni 17, shkronja b, neni 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr-28/2008), neni 5 paragrafi 1.2, nënparagrafi 1.2.2, neni 10, paragrafi 2 nënparagrafi 2.1, neni 11, 16 dhe neni 26 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr-30/2013), dhe Udhëzimit Administrativ MMPH Nr-24/2015, të datës 30.12.2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës, kërkesën e Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me Nr.1349-2/24, e datës 14.03.24, neni 36, paragrafi 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 28.03.2024 miraton këtë:

## V E N D I M

### për hartimin e hartës zonale të Komunës

#### Neni 1

#### Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

Me këtë vendim, Kuvendi Komunal i Vitisë miraton vendimin për fillimin e hartimit të Hartës Zonale Komunale të Vitisë.

#### Neni 2

#### Përkufizimi i dokumentit të planifikimit hapësinor

Me këtë vendim përkufizohet dokumenti i planifikimit hapësinor, Harta Zonale e Komunës në harmoni me ligjin përkufizohet si dokument multi-sektorial, që përmes grafikoneve, fotografive, hartave dhe tekstit përcakton hollësisht llojin, destinimin, shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës dhe masat e veprimit të cilat bazohen në kohëzgjatje dhe projeksione të arritshme të investimeve publike dhe private për tërë territorin e Komunës, për periudhën tetë (8) vjeçare

#### Neni 3

#### Qëllimi i hartimit

Me Hartën Zonale të Komunës nga neni 1 i këtij vendimi, përcaktohen kushtet zhvillimore dhe kushtet ndërtimore për zonat urbane dhe rurale në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale dhe mundësitë për të arritur kushte optimale të rregullimit dhe ndërtimit në Komunën e Vitisë, plotëson kërkesat ligjore për rregullimin e zhvillimeve në zonës urbane dhe rurale

#### Neni 4

Zona Kadastrale në territorin e Komunës së Vitisë janë:

Nr,	Zona Kadastrale	Shifra			m <sup>2</sup>
			ha	a	
1	Ballancë	70101001	755	15	72
2	Beguncë	70101002	480	53	3
3	Binçë	70101003	1236	22	31
4	Budrikë e Epërme	70101012	449	5	39
5	Buzovik	70101004	570	95	70
6	Debëlldeh	70101017	945	35	61
7	Devajë	70101018	364	84	57
8	Gërmovë	70101014	626	35	60
10	Gjylekarë	70101022	1084	40	50
11	Gushicë	70101016	1155	91	55
12	Kabash	70101025	725	91	2
13	Letnicë	70101027	443	12	8
14	Lubishtë	70101028	1084	81	63
15	Mjak	70101029	604	62	13
17	Novosellë	70101031	472	80	1
18	Podgorc	70101032	323	75	75
19	Pozheran	70101033	1120	30	31
20	Radivojc	70101035	365	87	31
21	Ramjan	70101020	675	65	13
22	Ramnishtë	70101034	94	76	12
23	Remnik	70101036	1068	21	48
24	Sadovinë e Jerlive	70101024	285	54	84
25	Sadovinë e Çerkezëve	70101040	840	75	80
26	Shasharje	70101042	1050	97	67
27	Sllatinë	70101037	1145	59	94
28	Smirë	70101038	1723	61	66
29	Stubëll e Epërme	70101013	652	77	77
30	Tërpezë	70101005	1331	87	4
31	Tërstenik	70101039	376	46	66
32	Vërban	70101008	803	86	81
33	Vërnakollë	70101010	556	74	35
34	Vërnez	70101011	842	48	3
35	Viti	70101007	1078	50	96
36	Zhiti	70101023	875	24	5
37	Drobesh	70101021	291	1	16
38	Stubëll e Poshtme	70101019	163	74	21
39	Goden i Madh	70101006	191	32	94
40	Qifllak	70101041	134	32	64

**Neni 5**  
**Subjekti përgjegjës për hartim**

Bartës i hartimit të Hartës Zonale Komunale (HZK-së) caktohet Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit (DUPMM).

## **Neni 6**

### **Mjetet dhe mekanizmat e nevojshëm për hartim**

Mjetet për hartimin e Hartës Zonale të Komunës sigurohen nga Buxheti i Komunës së Vitisë. Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit koordinon procesin e hartimit të Hartës Zonale të Komunës me drejtoritë sektoriale dhe burimet njerëzore brenda Komunës. Harta Zonale e Komunës hartohet në bazë të kontratës së lidhur në mes të Komunës së Vitisë dhe kontraktorit të përzgjedhur nga konkursi i projektimit përmes procedurave të prokurimit publik, sipas Ligjit Nr.03/L-241 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës.

## **Neni 7**

### **Afati I hartimit**

Bartësi i hartimit të dokumentit të planifikimit hapësinor, sipas nenit 1 të këtij vendimi është i obliguar që Hartën Zonale të Komunës ta hartoj në afat prej nëntë (9) muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

## **Neni 8**

### **Konsultime publike**

Projekti i Hartës Zonale të Kosovës para finalizimit duhet të vihet në konsultime publike dhe në shqyrtim publik. Paraqitja e Projektit të Hartës Zonale të Komunës në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen përmes njoftimeve publike.

## **Neni 9**

### **Afati i vlefshmërisë**

Harta Zonale e Komunës hartohet për periudhën kohore 8 (tetë) vjeçare.

## **Neni 10**

### **Gjuha zyrtare**

Dokumenti i planifikimit hapësinor sipas nenit 1 të këtij vendimi duhet të jetë në gjuhët zyrtare të Komunës dhe së paku në 3 (kopje) të shtypura e të vulosura dhe 3 kopje digjitale të origjinalit.

## **Neni 11**

### **Programi**

Pjesë e këtij vendimi është programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit i paraparë me nenin 11, pika 1.3 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr.04/L-174.

## **Neni 12**

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Vitisë, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit (DUPMM) dhe drejtoritë tjera.

## **Neni 13**

### **Hyrja ne fuqi**

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8, lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë. Me hyrjen ne fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi për iniciimin e procedurës për hartimin e hartës zonale të Komunës me Nr.01-110/05-183, i datës 01.03.2024.

Dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit;
2. Drejtorisë për Urbanizëm;
3. MAPL-së; dhe
4. Arkivit.

KRYESUESI I KUVENDIT

Bekim Azizi





**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



**Komuna e Vitisë**  
Opština Vitina - Municipality of Viti

---

DREJTORIA E URBANIZMIT, PLANIFIKIMIT DHE MBROJTJËS SË MJEDISIT

## HARTIMI I HARTËS ZONALE TË KOMUNËS SË VITISË

Harta Zonale e Komunës është një dokument multi-sektorial që përmes grafikoneve, fotografive, hartave dhe tekstit përcakton hollësisht llojin, destinimin, shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës dhe masat e veprimit të cilat bazohen në kohëzgjatje dhe projeksione të arritshme të investimeve publike dhe private për tërë territorin e Komunës, për një periudhë së paku tetë (8) vjeçare.

Në vitin 2013 është aprovuar Ligji i ri për Planifikim Hapësinor Nr.04/L-174, i cili parasheh në nivelin lokal këto dokumente: Planin Zhvillimor Komunal, Hartën Zonale të Komunës dhe Planet Rregulluese të Hollësishme.

Harta Zonale e Komunës përcakton sipërfaqet dhe masat për:

- zhvillimin ekonomik;
- zhvillimin e zonave bujqësore, banimit, komerciale, industriale, teknologjike dhe për shfrytëzim të përzier, dhe kushtet ndërtimore;
- përmirësimin e infrastrukturës teknike të nivelit lokal;
- përmirësimin e infrastrukturës publike të nivelit lokal;
- përmirësimin e infrastrukturës sociale të nivelit lokal;

- përmirësimin e sigurisë publike;
- mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera si dhe ndotja dhe degradimi i mjedisit;
- zhvillimin e turizmit dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore; 2.9. trajtimin e vendbanimeve joformale;
- dispozitat e zbatimit; dhe
- dispozitat e monitorimit të zbatimit.

Hartimi i Hartës Zonale të Komunës bazohet në:

- objektivat e planeve zhvillimore strategjike të sektorëve të ndryshëm të Qeverisë dhe Komunës, për administratë publike, arsim, shkencë dhe teknologji, agrikulturë, pylltari, zhvillim rural, siguri publike, trashëgimi kulturore, ngjarje kulturore, sport, mjedis, mirëqenie sociale, shëndetësi, infrastrukturë, ekonomi, tregti, industri, telekomunikacion, transport publik, shpërndarje të energjisë elektrike dhe termike;
- zhvillimin e qëndrueshëm, duke shfrytëzuar në mënyrë efikase fondet publike;
- trajtimin e vendbanimeve joformale;
- Hartën Zonale të Kosovës, Planin Zhvillimor Komunal dhe Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor.

Udhëzimi Administrativ Nr. 24/2015 ka përcaktuar procedurat, elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës.

Bazuar në Ligjin për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174, Autoriteti përgjegjës Komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor është përgjegjës për hartimin e Hartës Zonale të Komunës përmes koordinimit të Drejtorive sektoriale dhe burimeve njerëzore brenda komunës ose konkursit të projektimit, në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-241 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

Bazuar në rregullativën ligjore Harta Zonale duhet të hartohet sipas Normave të Planifikimit Hapësinorë, ky Udhëzim Administrativ Nr. 08/2017 për Normat teknike të Planifikimit Hapësinorë është miratuar nga MMMPH në gusht të vitit 2017 ndërsa udhëzuesin për hartimin e Hartës Zonale kjo Ministri e ka nxjerr në shkurt 2018.

Komuna deri në miratim të këtyre udhëzimeve vazhdimisht ka mbledhur informatat e nevojshme për fillimin e hartimit të këtij dokumenti.

**PROGRAMI PËR HARTIMIN DHE MENAXHIMIN E HARTËS ZONALE TË KOMUNËS**

<b>I Punët Parapërgatitore</b>				
<b>Detyrat</b>	<b>Aktivitetet</b>	<b>Qëllimi</b>	<b>Kohëzgjatja Javë</b>	<b>Përgjegjës</b>
1	Përcaktimi i udhëheqësit komunal të projektit dhe Grupit punues.	Përcaktimi i Grupit Punues.	1	Kryetari i Komunës
2	Përcaktimi i grupeve të interesit 2.1) Përcaktimi i grupeve lokale të interesit - institucionet në nivelin qendror; - Organizatat e Jashtme që ofrojnë shërbime publike; - OJQ; - Biznese; - Përfaqësues nga Bashkësitë Lokale. 2.2) Krijimi i listës dhe kontakteve të pjesëmarrësve.	Në mënyrë që procesi të jetë sa më transparent dhe gjithëpërfshirës.	1	Udhëheqësi Komunal i Projektit
3	Hartimi i konceptit dhe planit të punës 3.1) Shqyrtimi i Legjislacionit në fuqi për HZK; 3.2) identifikimi i rreziqeve dhe kërcënimeve; 3.3) Krijimi i strukturës përmbajtjesore; 3.5) Prezantimi i strukturës së dokumentit dhe konceptit të punës para drejtorive komunale.	Koordinimi i vazhdueshëm i Drejtorive Komunale, Plani i hollësishëm i punës gjatë procedurës së hartimit të HZK'së.	1	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës
4	Zhvillimi i takimeve njoftuese me banorët 4.1) Takime njoftuese me banorë të zonës urban dhe Grupin Punues; 4.2) Takime njoftuese me banorë të zonës rurale dhe Grupin Punues.	Njoftimi transparent dhe gjithëpërfshirës.	1	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës

<b>II Konsolidimi i të Dhënave të Dokumenteve Ekzistuese të Planifikimit Hapësinor</b>				
<b>Detyrat</b>	<b>Aktivitetet</b>	<b>Qëllimi</b>	<b>Kohëzgjatja Javë</b>	<b>Përgjegjës</b>
1	Konsolidimi i të dhënave hartografike nga PZHK, PZHU, PRRU-të.	Përmes hja e kërkesave të kërkuara nga UA për HZK.	3	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës

2	Konsolidimi i kushteve zhvillimore dhe kushteve ndërtimore ekzistuese	Konsolidimi i të dhënave hartografike nga PZHU, PRRU-të.	Përbushja e kërkesave të kërkuara nga UA për HZK.	2	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës
3	Shqyrtimi i ankesave, të parashtruara nga qytetarët nga viti 2011-2023 për planet ekzistuese	Formimi i Komisionit.	Për një planifikim të qëndrueshëm.	3	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe Komisioni Shqyrtues

III Identifikimi i të Dhënave Shtesë që Duhet të Përpunohen					
	Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja Javë	Përgjegjës
1	Vlerësimi i Përshtatshmërisë dhe përputhshmërisë së Kushteve Zhvillimore dhe Kushteve Ndërtimore ekzistuese me nevojat dhe PZHKNë e miratuar	1.1) Vlerësimi profesional; 1.2) Përgatitja e prezantimit dhe raporti vlerësues, duke përfshirë përcaktimin e kushteve shtesë që duhet të përgatiten në përputhje me UA për HZK; 1.3) Dorëzimi dhe prezantimi i raportit vlerësues për grupi punues (GP).	Përpunimi sipas kërkesave të UA për HZK.	2	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës
2	Inkorporimi i sugjerimeve për të dhëna shtesë nga GP	Plotësimi me të dhëna shtesë në rast se kjo vlerësohet e nevojshme nga GP.	Përbushja e kërkesave të përcaktuara sipas UA për HZK.	2	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës

IV Përgatitja e Kushteve të Përgjithshme Zhvillimore					
	Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja Javë	Përgjegjës
1	Përgatitja e kushteve të përgjithshme zhvillimore	1.1) Përpilimi i kushteve të përgjithshme zhvillimore, të cilat janë të zbatueshme për tërë territorin dhe shfrytëzimet e përcaktuar në PZHK; 1.2) Përgatitja e prezantimit të kushteve të përgjithshme zhvillimore dhe hartave; 1.3))Dorëzimi dhe prezantimi i raportit vlerësues nga GP.	Kushtet e përgjithshme zhvillimore duhet të përcaktohen për tërësinë territoriale më të gjërë që përmbajnë kritere të ngjashme.	3	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe konsulent/mbështetës
2	Inkorporimi i sugjerimeve për të dhëna shtesë nga KD dhe GP	Plotësimi me të dhëna shtesë në rast se kjo vlerësohet e nevojshme nga GP.	Përbushja e kërkesave të përcaktuara sipas UA për HZK.	2	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe konsulent/mbështetës
3	Zhvillimi i prezantimit publik të kushteve të përgjithshme zhvillimore.	Prezantimit publik të kushteve të përgjithshme zhvillimore.	Njoftim i banorëve me kushtet e përgjithshme zhvillimore.	1	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe konsulent/mbështetës
4	inkorporimi i sugjerimeve për të dhëna shtesë nga banorët	Plotësimi me të dhëna shtesë në rast se kjo vlerësohet e nevojshme nga GP.	Përfshirja e kërkesave të qytetarëve në procesin e planifikimit.	1	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe Sektori për Mjedis



V Përgatitja e Kushteve Zhvillimore dhe Kushteve Ndërtimore					
	Defyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja Javë	Përgjegjës
1	Përgatitja e Kushteve Zhvillimore dhe hartave për kushtet specifike	1.1) Përpilimi i kushteve zhvillimore për zonat e caktuara specifike tekstualisht dhe grafikisht; 1.2) Përgatitja e prezantimit të kushteve zhvillimore tekstualisht dhe grafikisht; 1.3) Dorëzimi dhe prezantimi i kushteve zhvillimore për GP.	Trajtim i veçantë për këto zona.	4	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës
2	Përgatitja e Kushteve ndërtimore dhe hartave për zonat e përcaktuara për ndërtim	2.1) Përpilimi i kushteve ndërtimore për zonat e përcaktuara për ndërtim; 2.1) Përgatitja e prezantimit të kushteve ndërtimore tekstualisht dhe grafikisht; 2.3) Dorëzimi dhe prezantimi i kushteve ndërtimore për GP.	Përbushja e kërkesave të përcaktuara sipas UA për HZK.	4	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës
3	Inkorporimi i sugjerimeve për të dhëna shtesë nga GP	Plotësimi me të dhëna shtesë në rast se kjo vlerësohet e nevojshme nga GP.	Përbushja e kërkesave të përcaktuara sipas UA për HZK.	1	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës
4	Zhvillimi i prezantimit publik të kushteve zhvillimore të përgjithshme dhe kushteve tjera dhe masave.	4.1) Prezantimit publik për banorët e zonës urbane; 4.1) Prezantimit publik për banorët e zonës rurale.	Njoftim i banorëve me kushtet e përgjithshme zhvillimore dhe masat.	1	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës
5	inkorporimi i sugjerimeve nga banorët	Plotësimi me të dhëna shtesë në rast se kjo vlerësohet e nevojshme nga GP.	Përfshirja e kërkesave të qytetarëve në procesin e planifikimit.	1	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës

<b>VI Përgatitja e Zonave Mbishtrësore dhe Kushteve Zhvillimore</b>					
<b>Detyrat</b>	<b>Aktivitetet</b>	<b>Qëllimi</b>	<b>Kohëzgjatja Javë</b>	<b>Përgjegjës</b>	
1	Përgatitja e Zonave Mbishtrësore dhe Kushteve Zhvillimore	1.1) Përpilimi i zonave mbishtrësore, kushteve zhvillimore tekstualisht dhe grafikisht; 1.2) Përgatitja e prezantimit për zonat mbishtrësore, kushteve zhvillimore tekstualisht dhe grafikisht; 1.3) Dorëzimi dhe prezantimi i zonave mbishtrësore, kushteve zhvillimore për GP.	Përmbushja e kërkesave të përcaktuara sipas UA për HZK.	4	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës
2	Inkorporimi i sugjerimeve për të dhëna shtesë nga GP	Plotësimi me të dhëna shtesë në rast se kjo vlerësohet e nevojshme nga GP.	Përmbushja e kërkesave të përcaktuara sipas UA për HZK.	2	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës
4	Zhvillimi i prezantimit publik të Zonave Mbishtrësore dhe Kushteve Zhvillimore	4.1) Prezantimit publik për banorët e zonës urbane; 4.2) Prezantimit publik për banorët e zonës rurale.	Njoftim i banorëve me kushtet zhvillimore.	1	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës
5	Inkorporimi i sugjerimeve nga banorët	Plotësimi me të dhëna shtesë në rast se kjo vlerësohet e nevojshme nga GP.	Përfshirja e kërkesave të qytetarëve në procesin e planifikimit.	1	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës

<b>VII Përgatitja e Kushteve Zhvillimore për Infrastruktura Teknike</b>					
<b>Detyrat</b>	<b>Aktivitetet</b>	<b>Qëllimi</b>	<b>Kohëzgjatja Javë</b>	<b>Përgjegjës</b>	
1	Përgatitja e kushteve zhvillimore dhe masat për infrastrukturë teknike	1.1) Përpilimi i kushteve zhvillimore për infrastrukturë teknike - pjesa tekstuale dhe grafike; 1.2) Përgatitja e prezantimit të kushteve zhvillimore për infrastrukturë teknike; 1.3) Dorëzimi dhe prezantimi i kushteve zhvillimore për infrastrukturë teknike për GP.	Përmbushja e kërkesave të përcaktuara sipas UA për HZK.	3	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës

2	Prezantimi i kushteve zhvillimore për infrastrukturë teknike për operatorët që veprojnë brenda komunës	2.1) KEDS, Ekohigjiena, Hidromorava etj.	Për një infrastrukturë teknike të qëndrueshme nevojitet bashkëpunim i ngushtë në mes të	2	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës
3	Inkorporimi i sugjerimeve për të dhëna shtesë nga operatorët	Plotësimi me të dhëna shtesë në rast se kjo vlerësohet e nevojshme nga GP.	Përbushja e kërkesave të përcaktuara sipas UA për HZK.	1	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës
4	Zhvillimi i prezantimit publik të kushteve zhvillimore për infrastrukturë teknike	4.1) Prezantimit publik për banorët e zonës urbane; 4.1) Prezantimit publik për banorët e zonës rurale.	Njoftim i banorëve me kushtet e përgjithshme zhvillimore për infrastrukturë teknike.	1	Udhëheqësi Komunal i Projektit konsulent/mbështetës
5	Inkorporimi i sugjerimeve nga banorët	Plotësimi me të dhëna shtesë në rast se kjo vlerësohet e nevojshme nga GP.	Përfshirja e kërkesave të qytetarëve në procesin e planifikimit.	1	Udhëheqësi Komunal i Projektit konsulent/mbështetës

VIII Përgatitja e Kushteve Zhvillimore për Infrastrukturë Rrugore					
	Detyrat	Aktivitetet	Kohëzgjatja Javë	Përgjegjës	
1	Përgatitja e kushteve zhvillimore dhe masave për infrastrukturë rrugore	1.1) Përpilimi i kushteve zhvillimore për infrastrukturë rrugore - pjesa tekstuale dhe grafike; 1.2) Përgatitja e prezantimit të kushteve zhvillimore për infrastrukturë rrugore; 1.3) Dorëzimi dhe prezantimi i kushteve zhvillimore për infrastrukturë rrugore për GP.	Përbushja e kërkesave të përcaktuara sipas UA për HZK.	3	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës

2	Inkorporimi i sugjerimeve për të dhëna shtesë nga operatorët në nivel lokal dhe qëndror	Plotësimi me të dhëna shtesë në rast se kjo vlerësohet e nevojshme nga GP.	Përbushja e kërkesave të përcaktuara sipas UA për HZK për infrastrukturë rrugore.	1	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës
3	Zhvillimi i prezantimit publik të kushteve zhvillimore për infrastrukturë rrugore	3.1) Prezantimit publik për banorët e zonës urban; 3.1) Prezantimit publik për banorët e zonës rurale.	Njoftim i banorëve me kushtet e përgjithshme zhvillimore.	1	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës
4	Inkorporimi i sugjerimeve nga banorët	Plotësimi me të dhëna shtesë në rast se kjo vlerësohet e nevojshme nga GP.	Përfshirja e kërkesave të qytetarëve në procesin e planifikimit.	1	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës

IX Përgatitja e Kushteve Zhvillimore për Infrastrukturë Publike dhe Sociale					
	Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja Javë	Përgjegjës
1	Përgatitja e Kushteve Zhvillimore për infrastrukturë publike dhe sociale.	1.1) Përpilimi i kushteve zhvillimore për infrastrukturë publike dhe sociale - pjesa tekstuale dhe grafike; 1.2) Përgatitja e prezantimit të kushteve zhvillimore për infrastrukturë publike dhe sociale; 1.3) Dorëzimi dhe prezantimi i kushteve zhvillimore për infrastrukturë publike dhe sociale për GP.	Përbushja e kërkesave të përcaktuara sipas UA për HZK.	3	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës
2	Inkorporimi i sugjerimeve për të dhëna shtesë nga banorët	Plotësimi me të dhëna shtesë në rast se kjo vlerësohet e nevojshme nga GP.	Përbushja e kërkesave të përcaktuara sipas UA për HZK.	1	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës

3	Zhvillimi i prezantimit publik të kushteve zhvillimore për infrastrukturë publike dhe sociale	4.1) Prezantimit publik për banorët e zonës urbane; 4.1) Prezantimit publik për banorët e zonës rurale.	Njoftim i banorëve me kushtet e përgjithshme zhvillimore.	1	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe Sektori për Mjedis
4	Inkorporimi i sugjerimeve nga banorët	Plotësimi me të dhëna shtesë në rast se kjo vlerësohet e nevojshme nga GP.	Përfshirja e kërkesave të qytetarëve në procesin e planifikimit.	1	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe Sektori për Mjedis

<b>X Caktimi i Zonave për Hartimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme</b>					
	Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja Javë	Përgjegjës
1	Aarsyrtimi për Hartimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme	1.1) Caktimi i zonave për hartimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme; 1.2) Dorëzimi dhe prezantimi i arsyetimit për hartimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme për GP.	Për zonat me interes të veçantë komuna do të përgatis arsyetimin për nevojën e hartimit të Planeve Rregulluese.	3	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës
2	Inkorporimi i sugjerimeve për të dhëna shtesë nga GP	Plotësimi me të dhëna shtesë në rast se kjo vlerësohet e nevojshme nga GP.	Përmblidhja e kërkesave të përcaktuara sipas UA për HZK.	1	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës

<b>XI Prezantimi Publik i Draft Kushteve Zhvillimore</b>					
	Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja Javë	Përgjegjës
1	Përgatitja e prezantimit publik të kushteve zhvillimore	1.1) Përgatitja e prezantimit publik të kushteve zhvillimore 1.2) Prezantimi i arsyetimit për nevojën e hartimit të planeve rregulluese të hollësishme të planifikuara për GP.	Njoftimi publik rreth zhvillimit të dokumentit.	2	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës

2	Zhvillimi i prezantimit të Kushteve Zhvillimore	4.1) Prezantimi publik për banorët e zonës urbane; 4.2) Prezantimi publik për banorët e zonës rurale.	Njoftim i banorëve me kushtet zhvillimore.	1	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës
3	Inkorporimi i sugjerimeve nga banorët	Plotësimi me të dhëna shtesë në rast se kjo vlerësohet e nevojshme nga GP.	Përfshirja e kërkesave të qytetarëve në procesin e planifikimit.	1	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës

<b>XII Përgatitja e Planit të Veprimit dhe Zbatimit</b>					
	<b>Detyrat</b>	<b>Aktivitetet</b>	<b>Qëllimi</b>	<b>Kohëzgjatja Javë</b>	<b>Përgjegjës</b>
1	Përgatitja e Planit të Veprimit dhe Zbatimit	1.1) Përpilimi i Planit të Veprimit dhe Zbatimit; 1.2) Përgatitja e prezantimit të Planit të Veprimit dhe Zbatimit; 1.3) Dorëzimi dhe prezantimi i Planit të Veprimit dhe Zbatimit për GP .	Përgatitje për të gjitha investimet kapitale, publike dhe publiko-private që parashihen në HZK.	3	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës
2	Inkorporimi i sugjerimeve për të dhëna shtesë nga KD dhe GP	Plotësimi me të dhëna shtesë në rast se kjo vlerësohet e nevojshme nga GP dhe KD.	Përbushja e kërkesave të përcaktuara sipas UA për HZK.	2	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës
4	Zhvillimi i prezantimit publik të Panit të Veprimit dhe Zbatimit	4.1) Prezantim publik për banorët e zonës urbane; 4.2) Prezantim publik për banorët e zonës rurale.	Njoftim i banorëve.	1	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës

5	Inkorporimi i sugjerimeve nga banorët	Plotësimi me të dhëna shtesë në rast se kjo vlerësohet e nevojshme nga GP.	Përfshirja e kërkesave të qytetarëve në procesin e planifikimit.	1	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës
---	---------------------------------------	--	--	---	---

XIII Përgatitja e Planit të Administrimit, Zbatimit dhe Monitorimi i Zbatimit					
Detyrat		Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja Javë	Përgjegjës
1	Përgatitja e Planit të Administrimit, Zbatimit dhe Monitorimi i Zbatimit	1.1) Përpilimi i Planit të Administrimit, Zbatimit dhe Monitorimi i Zbatimit; 1.2) Përgatitja e prezantimit të Planit të Administrimit, Zbatimit dhe Monitorimi i Zbatimit; 1.3) Dorëzimi dhe prezantimi i Planit të Administrimit, Zbatimit dhe Monitorimi i Zbatimit për GP.	Përgatitje për të gjitha investimet kapitale, publike dhe publike-private që parashihen në HZK.	3	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës
2	inkorporimi i sugjerimeve për të dhëna shtesë nga GP	Plotësimi me të dhëna shtesë në rast se kjo vlerësohet e nevojshme nga GP.	Përbushja e kërkesave të përcaktuara sipas UA për HZK.	1	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës
3	inkorporimi i sugjerimeve nga banorët	Plotësimi me të dhëna shtesë në rast se kjo vlerësohet e nevojshme nga GP.	Përfshirja e kërkesave të qytetarëve në procesin e planifikimit.	1	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës

XIV Konsolidimi dhe Përfundimi i Përbajtjes së HZK-së					
Detyrat		Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja Javë	Përgjegjës
1	Konsolidimi dhe përfundimi i përbajtjes së HZK-së	1.1) Përfundimi i kapitujve të sfondit; 1.2) Konsolidimi i tërë dokumentit.	Përbushja e ecurive ligjore gjatë hartimit të HZK-së.	3	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës

2	Dorëzimi i HZK-së në MMPH për vlerësimin e përmbajtjes para organizimit të shqyrtimit publik	2.1) Dorëzimi i drafrit përfundimtar të HZK-së në MMPH; 2.2) Përgatitja dhe organizimi i prezantimit të drafrit përfundimtar të HZK-së në MMPH; 2.3) Vlerësimi nga MMPH-ja për iniciimin e shqyrtimit publik të drafrit përfundimtar të HZK-së.	Përmbushja e ecurive ligjore gjatë hartimit të HZK-së.	4	Udhëheqësi Komunal i Projektit, në bashkëpunim me GP
---	--	---	--	---	--

XV Hartimi i Vlerësimit Strategjik Mjedisor për HZK					
	Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja Javë	Përgjegjës
1	Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) Pasqyra Hartimi i këtij dokumenti paralelisht me fazat e tjera në procedure të HZK-së	1.1) Vlerësimi i kushteve zhvillimore; 1.2) Vlerësimi i kushteve ndërtimore; 1.3) Vlerësimi i Zonave mbishitësore; 1.4) Vlerësimi i masave të marrura; 1.3) VSM takime dhe konsultime sipas nevojës etj.	Përmbushja e ecurive ligjore gjatë hartimit të HZK-së.	Gjatë gjithë procesit	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe Sektori për Mjedis
2	Konsultimi Publik i VSM	1.1) Mbajja e konsultimit publik për 30 ditë; 1.2) Mbajja e debatit publik në një datë të caktuar nga udhëheqësi dhe hartuesi	Informimi i qytetarëve me Vlerësimin Strategjik Mjedisor, dhe masat rekomandimet	4	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe Sektori për Mjedis

XVI Shqyrtimi Publik i HZK-së					
	Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja Javë	Përgjegjës
1	Vendimi për Zhvillimin e Shqyrtimit Publik	3.1.1 Përgatitja e Vendimit për Shqyrtim Publik; 3.2.2 Njoftimi publik përmes Gazetës Zyrtare dhe mediave siç e parasheh UA për pjesëmarrjen e publikut në shqyrtime publike.	Përmbushja e ecurive ligjore gjatë hartimit të HZK-së.	2	Udhëheqësi Komunal i Projektit
2	Organizimi i Shqyrtimit Publik	3.1) Hapja Zyrtare e Shqyrtimit Publik dhe Prezantimi publik i drafrit të parë; 3.2) Ekspozimi i drafrit; 3.3) Pranimi i komenteve, vërejtjeve dhe sugjerimeve nga qytetarët dhe hisedarët tjerë.	Planifikim transparent dhe gjithëpërfshirës.	4	Udhëheqësi Komunal i Projektit me sektorin e planifikimit
3	Raporti i Shqyrtimit Publik	Përgatitja e raportit të shqyrtimit publik.	Përmbushja e ecurive ligjore gjatë hartimit të HZK-së.	2	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe komisioni



4	Inkorporimi i vërejtjeve, komenteve dhe sugjerimeve	Ndryshimi, plotësimi, harmonizimi i HZK-së në përputhje me vërejtjet, komentet dhe sugjerimet e arsyeshme të evidentuara.	Përbushja e ecurive ligjore gjatë hartimit të PZHK'së.	3	Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës
---	---	---	--	---	---

XVII Miratimi i HZK-së					
Detyrat		Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja Javë	Përgjegjës
1	Miratimi i HZK-së nga MMPH'ja	1.1) Dorëzimi i HZK-së për miratim në MMPH; 1.2) inkorporimi i vërejtjeve, komenteve dhe sugjerimeve nga MMPH'ja nëse ka; 1.3) Miratimi i HZK-së nga MMPH'ja.	Përbushja e ecurive ligjore gjatë hartimit të HZK-së.	2	Udhëheqësi Komunal i Projektit
2	Miratimi i HZK-së nga Kuvendi Komunal	2.1) Dorëzimi i HZK-së për miratim në Kuvendin Komunal; 2.2) inkorporimi i vërejtjeve, komenteve dhe sugjerimeve nga Kuvendi Komunal, në rast se ka; 2.3) Miratimi i PZHK'së nga MMPH'ja.	Përbushja e ecurive ligjore gjatë hartimit të HZK-së.	1	Kryetari i Komunës dhe Kuvendi Komunal